

	KODI I RRJETIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 1 nga 53</i>

KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Tetor 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Hyrje.....	2
2	Struktura e Kodit të Rrjetit.....	3
3	Përgjegjësitë e palëve	4
3.1	OSTT	4
3.2	Pronar i Sistemit të Transmetimit.....	5
3.3	Operator i Tregut.....	5
3.4	Gjeneruesit.....	6
3.5	Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes	6
3.6	Furnizuesit.....	7
4	Objektivi.....	7
5	Fushëveprimi	8
6	Situatat e paparashikuara.....	8
7	Rishikimi i Kodit të Rrjetit të Transmetimit.....	8
8	Kontestet	8
9	Derogimet	9
9.1	Aplikimi për derogim.....	9
9.2	Dhënia e derogimit	10
9.3	Dështimi për miratimin e një derogimi.....	10
9.4	Dështimi i OSTT në përmbushjen e një dispozite të Kodit të Rrjetit.....	Error! Bookmark not defined.
10	Administratori i kodit.....	12
11	Ruajtja e fshehtësisë.....	12
12	Komunikimi ndërmjet palëve.....	13
13	Përcaktimi i termave	13

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 2 nga 53</i>

1 Hyrje

- 1.1 **Operatori i Sistemit të Transmetimit** zhvillon **Kodin e Rrjetit të Transmetimit** në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për Energjinë Elektrike dhe **Licencën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit** dhe **Zyra e Rregullatorit për Energji** e miraton atë.
- 1.2 **Kodi i Rrjetit** mbulon procedurat për operimin e sistemit të transmetimit dhe bashkëveprimin ndërmjet **OSTT** dhe shfrytëzuesit dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Në tërësi përfshin proceset e planifikimit, kyçjes, operimit dhe balancimit të sistemit në kushte normale dhe të jashtëzakonshme. Këto procese përfshijnë periudha kohore të ndryshme nga planifikimi afatgjatë (dhjetë vite) deri në atë në kohën reale si dhe periudhat pas ndodhjes së ndonjë ngjarje apo avarie. **Kodi i Rrjetit të transmetimit** është i obligueshëm për **OSTT** dhe për të gjithë shfrytëzuesit e sistemit të transmetimit dhe pjesëmarrësit e tregut.
- 1.3 **Kodi i rrjetit të transmetimit** përcakton:
- 1.3.1. kushtet teknike dhe kërkesa të tjera të cilave duhet t'iu përmbahen shfrytëzuesit e lidhur në **rrjetin e transmetimit**;
 - 1.3.2. kushtet teknike dhe kërkesa tjera për transmetim të sigurtë të energjisë elektrike nga prodhues dhe sistemet tjera dhe operim të sigurtë të **sistemit të transmetimit** për furnizim të besueshëm dhe cilësor të energjisë elektrike te konsumatorët fundorë;
 - 1.3.3. kushtet teknike për qasje në **rrjetin e transmetimit**;
 - 1.3.4. kushtet teknike për mirëmbajtje të **rrjetit të transmetimit**;
 - 1.3.5. përgjegjësitë teknike të përdoruesve të **rrjetit të transmetimit**;
 - 1.3.6. planifikimin operativ dhe menaxhimin e **sistemit të transmetimit**;
 - 1.3.7. procedurat për operimin e sistemit të energjisë elektrike në kushte të operimit normal dhe fuqisë madhore, rrjeteve të çrregulluara, rrjeteve të jashtëzakonshme apo rrethanave tjera të jashtëzakonshme;
 - 1.3.8. zonat e mbrojtura dhe kushtet e veçanta brenda fushës së mbrojtur të stabiliteteve elektrike;
 - 1.3.9. llojet dhe ofrimin e shërbimeve ndihmëse të sistemit;
 - 1.3.10. kushtet teknike dhe kushtet tjera për interkoneksion dhe operim të rrjeteve;
 - 1.3.11. planifikimin zhvillimor të **rrjetit të transmetimit**;
 - 1.3.12. dizajnin teknik dhe kërkesat operative për kyçje në sistem që do të sigurojë bashkëveprimin e sistemeve dhe do të jenë objektive dhe jodiskriminuese.
- 1.4 Versioni në gjuhën shqipe i **Kodit të Rrjetit** do të jetë mbizotërues. Në rast të ndonjë mospajtimi, mospërputhje apo konfuzioni që shkaktohet ndërmjet origjinalit në gjuhën shqipe dhe përkthimit në gjuhën angleze atëherë versioni në gjuhën shqipe do të ketë përparësi.

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 3 nga 53</i>

2 Struktura e Kodit të Rrjetit

Kodi i Rrjetit është dokument i vetëm dhe i plotë por për qëllime të përdorimit dhe revidimit më të lehtë është ndarë në disa kapituj:

- 1) **Dispozita të përgjithshme** – në këtë pjesë përshkruhet struktura e **Kodit të Rrjetit**, procedurat që kanë të bëjnë me situatat e paparashikuara, kontestet, derogimet, rishikimet e **Kodit të Rrjetit**, si dhe listën me termat e përcaktuara, shkurtesave dhe kuptimin e tyre kur përdoren si të tilla në **Kodin e Rrjetit**;
- 2) **Kodi i Planifikimit** – specifikon kërkesat për mbledhjen e të dhënave dhe informatave të besueshme nga **shfrytëzuesit**, në mënyrë që **OST** të mund të bëjë planifikimin dhe zhvillimin e **Sistemit të Transmetimit** të Kosovës;
- 3) **Kodi i Kyçjes** – specifikon kushtet, kriteret dhe afatet kohore që duhet të përmbushen nga **OST** dhe **shfrytëzuesit** e kyçur ose që kërkojnë të kyçen direkt në **Sistemin e Transmetimit**;
- 4) **Kodi i Planifikimit Operativ** – përfshin periudhën një vit para deri në fazën e balancimit në kohë reale të operimit. Përbëhet nga tre nën-kode: **kodi i planifikimit të ndërprerjeve** që mbulon planifikimin dhe koordinimin e orarit të **ndërprerjeve** në sistem; **kodi i vlerësimit të sistemit** që mbulon vlerësimin e sigurisë së sistemit dhe parashikimin e ngarkesës dhe **kodi i programimit** që mbulon procesin e programimit për një ditë para;
- 5) **Kodi i Balancit** – përfshin procedurat lidhur me balancimin ndërmjet gjenerimit dhe ngarkesës së sistemit në kohë reale. Përbëhet nga tre nën-kode: **kodi i dispeçimit** që mbulon procedurat dhe proceset për dispeçim, për balancim, **shërbime ndihmëse** dhe rastet emergjente, **kodi i rregullimit të frekuencës** që mbulon proceset për rregullimin e frekuencës së sistemit dhe **kodi i rregullimit të tensionit** që ka të bëjë me masat për rregullimin e tensionit dhe energjisë reaktive;
- 6) **Kodi Operativ** – është i ndarë në disa nën-kode dhe përfshin – **kodin e testimit dhe monitorimit** që specifikon procedurat për të mundësuar monitorimin e **shfrytëzuesve** dhe testimin e rrjetit në pajtueshmëri me kërkesat e **Kodit të Rrjetit**, **kodin e ndërlidhjes operative dhe furnizimit me informacione për ngjarjet/ndodhitë** që mbulon shkëmbimin e

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 4 nga 53</i>

informacioneve në kushte normale dhe jo-normale, **kodin e koordinimit të sigurisë** që ka të bëjë me procedurat për të lejuar punimet dhe/ose testimet në një **pikë të kyçjes**, **kodin e planifikimit të rasteve të paparashikuara** që mbulon dispozitat e rasteve të paparashikuara dhe planet e rikthimit pas rënies totale ose të pjesshme të sistemit, **kodin e rregullimit të ngarkesës** që mbulon procedurat e nevojshme për reduktimin e **ngarkesës**, **kodin e identifikimit të stabilimentit dhe aparaturave** që paraqet përgjegjësitë dhe procedurat për numërimin dhe nomenklaturën e stabilimenteve për t'u përdorur në të gjitha vendet dhe **kodin e testimit të sistemit** që mbulon aranzhimet për kryerjen e testeve që mund të kenë ndikim mbi **palët** tjera;

3 Përgjegjësitë e palëve

3.1 OSTT

OSTT vepron si **operatori i sistemit**, pronar i **sistemit të transmetimit** dhe **operatori i tregut**.

OSTT si **Operator i Sistemit të Transmetimit**, kryen funksionet e mëposhtme:

- a) Ruajtjen e cilësisë dhe sigurinë e furnizimit;
- b) Lehtësimin e tregut të energjisë elektrike – si të tregut Kosovar dhe të atij rajonal;
- c) Furnizimin e **Operatorit të Tregut** dhe **palëve** të tjera me informacione të përditshme;
- d) Menaxhimin e **Sistemit të Transmetimit** dhe rrjedhave interkonektive të energjisë dhe fuqisë;
- e) Koordinimin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike në përputhje me marrëveshjet ekzistuese;
- f) Sigurimin e **shërbimeve ndihmëse**;
- g) Balancimin e **ngarkesës** dhe **gjenerimit** në sistemin e Kosovës;

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 5 nga 53</i>

- h) Planifikimin e **ndërprerjes** për **sistemin e transmetimit** dhe për **përdoruesit** e lidhur direkt me **sistemin e transmetimit**;
- i) Instalimin, mirëmbajtjen dhe operimin e pajisjeve matëse;
- j) Mirëmbajtjen e infrastrukturës së telekomunikacionit;
- k) Mirëmbajtjen e infrastrukturës së **SCADA** sistemit.

3.2 Pronar i Sistemit të Transmetimit

OST si pronar i **Sistemit të Transmetimit**, kryen këto funksione:

- a) Planifikimin, operimin dhe mirëmbajtjen e **Sistemit të Transmetimit**;
- b) Menaxhimin e asetëve të **Sistemit të Transmetimit**
- c) Ndërmarrjen e procedurave për menaxhimin e sigurisë;
- d) Planifikimin afatgjatë të sistemit;
- e) Menaxhimin e projekteve për zgjerimin e sistemit;
- f) Aranzhimet për kyçje të reja dhe inspektimin e kyçjeve ekzistuese:

3.3 Operator i Tregut

Operatori i Tregut, kryen këto funksione:

- a) Administron **Rregullat e Tregut**;
- b) Administron dhe zhvillon procedurat e tregut
- c) Menaxhon procesin e aderimit të **palëve** në **Rregullat e Tregut**;
- d) Menaxhon procesin e modifikimit të **Rregullave të Tregut**;
- e) Operon ankandin e kapaciteteve interkonektive (mekanizmin për alokimin e kapaciteteve transferuese)
- f) Operon me tregun një ditë para;
- g) Regjistron kontratat bilaterale (notifikimin e kontratave);

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 6 nga 53</i>

- h) Grumbullon dhe përpunon të dhënat matëse;
- i) Udhëheqë barazimin (setelmentin) e tregut;
- j) Monitoron **palët tregtare** për shkelje të rregullave dhe i raporton **ZRrE**-së për shkelje të rënda.
- k) Publikon informatat e tregut.

3.4 Prodhuesit

Përgjegjësitë e prodhuesve janë:

- a) T'i ofrojë **OST** kapacitetet e prodhimit në dispozicion për nevoja të operimit të sistemit, sigurisë së sistemit dhe balancimit të sistemit;
- b) T'i ofrojë **OST** dhe **OSSH** shërbimet ndihmëse dhe të balancimit, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike në përputhje me parametrat dinamik të Kodit të rrjetit të transmetimit dhe Rregullave të Tregut të energjisë elektrike si dhe të nënshkruaj kontrata sipas marrëveshjeve të arritura dhe të aktivizojë stabilimentet prodhuese me kërkesë të **OST** me qëllim të ofrimit të shërbimeve ndihmëse dhe atyre të balancimit;
- c) Ofrimin e informacioneve të shpejta për **Operatorin e Sistemit** për ndodhitë/ngjarjet e planifikuara dhe të paplanifikuara;
- d) Lejimi i qasjes për testime, inspektime ose grumbullim të dhënash:

3.5 Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes

Përgjegjësitë e **Operatorëve të Sistemit të Shpërndarjes** janë:

- a) Përgjigja ndaj udhëzimeve nga **Operatori i Sistemit** për rregullimin e tensionit;
- b) Sigurimin e informacioneve për parashikimin e kërkesave për energji elektrike dhe informacione tjera të kërkuara nga **Operatori i Sistemit të Transmetimit**, Ministria përkatëse apo **Rregullatori**.

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 7 nga 53</i>

3.6 Furnizuesit

Përgjegjësitë e furnizuesve janë:

- a) Të bëj marrëveshje për qasjen në sistem me **operatorin e sistemit** në të cilin janë lidhur stabilimentet e konsumatorëve të tij;
- b) Të lidhë kontratë për balancim me **Operatorin e Sistemit të Transmetimit** ose të lidh kontratë anëtarësimi në grupin e balancimit me udhëheqësin e këtij grupi në përputhje me Rregullat e Tregut;

4 Objektivi

- 4.1 Objektivi i përgjithshëm i **Kodit të Rrjetit të Transmetimit** është të sigurojë, aq sa është e mundur që seksionet e ndryshme të **Kodit të Rrjetit** të jenë në bashkëveprim me kodet tjera teknike dhe **rregullat e tregut** në interes të operimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, për të gjithë pjesëmarrësit e tregut dhe konsumatorët.
- 4.2 Si objektivi specifik i **Dispozitave të përgjithshme** është vendosja e rregullave për t'u përballur me situatat e mëposhtme:
 - a) Situatat e paparashikuara si në nenin 6;
 - b) Menaxhimin e implementimit të **Kodit të Rrjetit** duke përfshirë procedurat që do të kryhen për propozimin, ndryshimin dhe zbatimin e ndryshimeve.
 - c) Derogimet nga të cilat një **palë** nuk mund të përmbushë kërkesat që dalin nga **Kodi i Rrjetit**;
 - d) Kontestet;
 - e) Administrimin e kodit;
 - f) Ruajtjen e fshehtësisë;
 - g) Komunikimet ndërmjet **palëve**.

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>fajqe 8 nga 53</i>

5 Fushëveprimi

- 5.1 Përgjegjësit kryesor për zbatimin e **Kodit të Rrjetit të Transmetimit** është **Operatori i Sistemit të Transmetimit** i cili do të monitoroj implementimin e **Kodit të Rrjetit të Transmetimit** dhe në baza vjetore do të raportoj te **Rregullatori** mbi implementimin e tij. Poashtu të gjithë shfrytëzuesit e sistemit të transmetimit janë përgjegjës për implementimin e Kodit të Rrjetit të cilët duhet të zbatojnë urdhërat dhe udhëzimet e lëshuara nga OST.

6 Situatat e paparashikuara

Nëse paraqiten situata që në dispozitat e **Kodit të Rrjetit** nuk janë parashikuar, **OSTT** duhet të konsultohet menjëherë me të gjitha **palët** e dëmtuara në mënyrë të arsyeshme me rrethanat duke u përpjekur të arrijë marrëveshje se çfarë veprimesh duhet të ndërmerren. Nëse marrëveshja mes **OSTT** dhe atyre palëve nuk mund të arrihet në kohën e mundshme, **OSTT** do t'i drejtohet **KQKO**-së i cili do të përcaktoj se çfarë veprime duhet të ndërmerren deri në vendimin e **Rregullatorit**.

7 Rishikimi i Kodit të Rrjetit të Transmetimit

Kodi i Rrjetit të Transmetimit përcakton kushtet që duhet të përmbahen nga të gjitha **palët**. Rishikimet e **Kodit të Rrjetit** do të ndërmerren nga **Komisioni Qeverisës i Kodeve Operacionale (KQKO)** sipas dokumentit “**Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale**” të miratuara nga Rregullatori. **OSTT** do të merr përgjegjësinë për inkorporimin e amendamenteve të dakorduara nga **KQKO** dhe të miratuara nga **Rregullatori** dhe për publikimin e kodit të amendamentuar.

8 Kontestet

- 8.1 **Kodi i Rrjetit të Transmetimit** përmban rregulla të cilat janë të detyrueshme dhe janë në përgjithësi specifike që mbulojnë shumicën e situatave që ka gjasë të ndodhin në fushat e mbuluara nga **Kodi i Rrjetit të Transmetimit**. Të gjitha **palët**, gjatë implementimit të këtyre rregullave duhet të veprojnë gjithnjë në mirëbesim. Synimi duhet të jetë që të përpiqemi dhe të sigurohemi që mos të paraqiten konteste aq sa të jetë e mundur.
- 8.2 Kontestet që vijnë si rezultat i operimit të **Kodit të Rrjetit të Transmetimit** do të zgjidhen në përputhje me “**Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në**

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 9 nga 53</i>

Sektorin e Energjisë” të miratuar nga **Rregullatori** për kontestet që paraqiten mes palëve në tregun e energjisë.

9 Derogimet

Të gjitha **palët** që detyrohen me dispozitat e **Kodit të Rrjetit** (përveç dispozitave të Kodit të Kyçjes për të cilin rregullat për derogime shpjegohen brenda tij) duhet të jenë plotësisht në pajtim me dispozitat e tij në të gjitha aspektet. Aty ku një **palë** nuk mund t’i përmbushë plotësisht kërkesat e dispozitave të **Kodit të Rrjetit** atëherë ajo **palë** duhet të kërkojë **derogim**.

9.1 Aplikimi për derogim nga Pala

- 9.1.1 Sapo një **palë** e vëren se nuk është në gjendje të plotësoj një ose më shumë dispozita të **Kodit të Rrjetit të Transmetimit**, atëherë ajo **palë** duhet të informojë menjëherë **OST** dhe të kërkojë derogim për dispozitat perkatëse.
- 9.1.2 Brenda dy javëve nga marrja e një kërkesë nga një **Palë** për një derogim, **OST** do t’i konfirmojë **Palës** nëse kërkesa është e plotë. Nëse **OST** konsideron se kërkesa është jo e plotë, atëherë **Pala** duhet të dorëzojnë informatat shtesë të kërkuara nga **OST** brenda një muaji nga marrja e kërkesës për informacione shtesë. Nëse **Pala** nuk ofron informacionin e kërkuar brenda këtij afati, kërkesa për një derogim do të konsiderohet e tërhequr.
- 9.1.3 Brenda gjashtë muajve nga marrja e një kërkesë për një derogim, **OST** do ta përcjellë kërkesën tek **Rregullatori** dhe do të dorëzojë vlerësimet e përgatitura lidhur me kërkesën për derogim. Kjo periudhë mund të zgjatet me një muaj kur **OST** kërkon informacion të mëtejshëm nga **Pala**.
- 9.1.4 **Rregullatori** do të miratojë një vendim në lidhje me çdo kërkesë për një derogim brenda gjashtë muajve nga dita pas pranimit të kërkesës. Ky afat kohor mund të zgjatet me tre muaj përpara skadimit të tij, kur **Rregullatori** kërkon informacion të mëtejshëm nga Pala përmes **OST**. Periudha shtesë do të fillojë kur të jetë marrë informacioni i plotë
- 9.1.5 **Pala** përmes **OST** do të paraqesë çdo informacion shtesë të kërkuar nga **Rregullatori** brenda dy muajve nga kërkesa e tillë. Nëse **Pala** nuk jep informacionin e kërkuar brenda këtij afati kohor, kërkesa për një derogim do të konsiderohet e tërhequr, përveç nëse:
- a) **Rregullatori** vendos të ofrojë një shtyrje; ose

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 10 nga 53</i>

- b) **Pala** njofton **Rregullatorin** me anë të një parashtrese të arsyetuar se kërkesa për një derogim është e plotë

9.1.6 Kërkesa për derogim do të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- c) Dispozita që nuk mund të plotësohet;
- d) Arsyeja për pamundësinë e plotësimit të dispozitës;
- e) Koha apo afati deri kur nuk mund të plotësohet ;
- f) Ndikimi në dështimin e plotësimit të dispozitës;
- g) Data e përafërt se kur kushti mund të përmbushet plotësisht

9.2 Dhënia e derogimit për Palët

9.2.1.1 **Rregullatori** përmes **OST** do të njoftojë vendimin e tij tek **Pala**. Përveçse nëse nuk ceket ndryshe në vendim nga **Rregullatori** dhe në rrethana të jashtëzakonshme një derogim do të mbetet në fuqi për një periudhë maksimale prej tre vitesh nga koha kur është dhënë lejimi për derogim, pas së cilës do të kërkohej të bëhet një ri-aplikim

9.3 Aplikimi për derogim nga OST

9.3.1 Sapo **OST** të vëren se nuk është në gjendje të plotësoj një ose më shumë dispozita të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, atëherë ajo duhet të informojë menjëherë **Rregullatorin** dhe të kërkojë derogim për dispozitat përkatëse

9.3.2 Çdo kërkesë për një derogim duhet të përfshijë:

- a) Dispozita që nuk mund të plotësohet;
- b) Arsyeja për pamundësinë e plotësimit të dispozitës;
- c) Koha apo afati deri kur nuk mund të plotësohet ;

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 11 nga 53</i>

d) Ndikimi në dështimin e plotësimit të dispozitës;

9.3.3 **Rregullatori** do të miratojë një vendim në lidhje me çdo kërkesë për një derogim brenda gjashtë muajve nga dita pas pranimit të kërkesës. Ky afat kohor mund të zgjatet me tre muaj përpara skadimit të tij kur **Rregullatori** kërkon informacion të mëtejshëm nga **OST**. Periudha shtesë do të fillojë kur të jetë marrë informacioni i plotë

9.3.4 **OST** do të paraqesë çdo informacion shtesë të kërkuar nga **Rregullatori** brenda dy muajve nga kërkesa e tillë. Nëse **OST** nuk jep informacionin e kërkuar brenda këtij afati kohor, kërkesa për një derogim do të konsiderohet e tërhequr, përveç nëse:

a) **Rregullatori** vendos të ofrojë një shtyrje; ose

b) **OST** njofton **Rregullatorin** me anë të një parashtrere të arsyetuar se kërkesa për një derogim është e plotë.

9.4 Dhënia e derogimit për OST

9.4.1.1 **Rregullatori** do të njoftojë vendimin e tij tek **OST**. Përveç nëse nuk ceket ndryshe në vendim nga **Rregullatori** dhe në rrethana të jashtëzakonshme një derogim do të mbetet në fuqi për një periudhë maksimale prej tre vitesh nga koha kur është dhënë lejimi për derogim, pas së cilës do të kërkohet të bëhet një ri-aplikim.

9.5 Dështimi për përmbushjen e një derogimi nga Pala dhe OST

Në qoftë se një **palë** ose **OST** nuk mundet t'i përmbushë kërkesat e këtij **Kodi të Rrjetit** dhe dështon në miratimin e një derogimi atëherë do të aplikohen sanksionet si në vijim:

a) Pala do të marrë një paralajmërim me shkrim prej **OST**;

i. Në qoftë se situata nuk rregullohet brenda dy muajve nga marrja e paralajmërimit të mësipërm, do të lëshohet një paralajmërim final,

ii. Nëse brenda dy muajve të tjerë situata nuk është rregulluar, atëherë **OST** do të konsultohet me **Rregullatorin** dhe do të aplikojë një gjobë që variron nga një gjobë monetare deri në shkyçjen nga **sistemi**.

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 12 nga 53</i>

b) **OST** do të marrë një paralajmërim me shkrim prej **Rregullatori**.

- i. Në qoftë se situata nuk rregullohet brenda dy muajve nga marrja e paralajmërimit të mësipërm, do të lëshohet një paralajmërim final,
- ii. Nëse brenda dy muajve të tjerë situata nuk është rregulluar, atëherë **Rregullatori** do të aplikojë masat perkatëse.

10 Administratori i kodit

OSTT është administrator i Kodit të Rrjetit. Funkcionet e administratorit të kodit përfshijnë;

- a) Mbajtjen e kopjes kryesore të azhurnuar të **Kodit të Rrjetit** duke siguruar se janë përfshirë të gjitha rishikimet e miratuara në të;
- b) Publikimin e versionit aktual të miratuar në faqen elektronike;
- c) Publikimin e ndryshimeve të propozuara në faqen elektronike;
- d) Publikimin e ndryshimeve të miratuara në faqen elektronike;
- e) Informimin me shkrim, të të gjitha palëve të cilat janë **shfrytëzues** të **Sistemit të Transmetimit** për këtë informacion se ka pasur ndryshime të propozuara, të miratuara ose version i ri i **Kodit të Rrjetit** që është i disponueshëm në faqen elektronike.

11 Ruajtja e fshehtësisë

- 11.1 Të gjitha të dhënat dhe informacioni i shkëmbyer ndërmjet **palëve** në **Kodin e Rrjetit** dhe që kërkohet prej tyre në mënyrë që të përmbushin detyrimet e tyre sipas **Kodit të Rrjetit**, duhet të trajtohet si informacion konfidencial përveçse nëse janë dakorduar ndryshe.
- 11.2 Të dhënat dhe informacionet e shkëmbyera për një qëllim të caktuar duhet të përdoren vetëm për atë qëllim, përveç nëse kur të dyja **palët** dakordohen ndryshe.
- 11.3 **OSTT** lirohet prej obligimeve sipas këtij seksioni kur të dhënat duhet të ofrohen ose nëpërmjet raportimit të rregullt ose me kërkesë nga qeveria, **Rregullatori**, gjykatat dhe

	KODI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	PO-KO-005
	<i>ver. 2.4</i>	<i>faqe 13 nga 53</i>

institucione të tjera shtetërore, bazuar në rregullat ekzistuese ose në procedimet ligjore. Në këto rrethana **OSTT** obligohet të njoftojë **palën** që i ka dorëzuar të dhënat relevante në çfarëdo rasti.

12 Komunikimi ndërmjet palëve

- 12.1 Përveç nëse është specifikuar ndryshe në **Kodin e Rrjetit**, të gjitha instruksionet e dhëna nga **OSTT** dhe komunikimet ndërmjet **OSTT** dhe **palëve** të tjera do të kryhen ndërmjet stafit në qendrën e kontrollit të **OSTT** dhe stafit të njoftuar në **OSTT** nga secila **palë** tjetër.
- 12.2 Të gjitha udhëzimet e dhëna nga **OSTT** dhe komunikimet ndërmjet **OSTT** dhe **palëve** të tjera do të kryhen me telefon ose me shkrim. Aty ku udhëzimet jepen me telefon, nëse e kërkon ndonjëra nga **palët** atëherë ato duhet të mbështeten me një konfirmim të shkruar.
- 12.3 Nëse qendra e kontrollit e **OSTT** ose qendra e kontrollit e një **pale** tjetër, zhvendoset në një vend tjetër, për shkak të një emergjence ose për ndonjë arsye tjetër, **OSTT** ose **pala** tjetër, aty ku është e nevojshme, duhet ta njoftojnë njëra tjetrën për vendndodhjen e re sa më shpejtë që të jetë e mundur pas zhvendosjes.

13 Përcaktimi i termave

- 13.1 Termat në **Kodin e Rrjetit** që janë me shkronja të theksuara janë termat e përcaktuara dhe duhet të interpretohen sipas listës së përkufizimeve në këtë kapitull. Një fjalë që formon plotësisht apo pjesërisht një term të përcaktuar dhe që nuk është me shkrim të theksuar nuk do të trajtohet si term i përcaktuar.
- 13.2 Termat që janë me shkrim të theksuar (bold) janë terma të përcaktuara dhe duhet të interpretohen sipas përkufizimeve në Nenin 1 Përcaktimi i Termave.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
------	-----------	--------	------------



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Aftësia funksionale për shkycje të kërkesës në nën-frekuencë			Nënkupton një veprim ku kërkesa shkyçet gjatë një ndodhie me frekuencë të ulët për të rikthyer balancën midis kërkesës dhe gjenerimit dhe për të rikthyer frekuencën e sistemit në kufij të pranueshëm.
Aftësia e kalimit nëpër prishje			Do të thotë aftësia e pajisjeve elektrike për të qenë në gjendje të mbetet e kyçur në rrjet dhe të veprojë përmes periudhave me tension të ulët në pikën e kyçjes të shkaktuar nga prishjet e izoluara
Aftësia e startimit nga errësira			Do të thotë aftësia e ristartimit të modulit gjenerues pas rënies totale nëpërmjet një burimi ndihmës pa furnizim të jashtëm me energji elektrike të centralit të gjenerimit.
Alternatori			Nënkupton pajisjen që energjinë mekanike e konverton në energji elektrike me anë të një fushe magnetike rrotulluese
Blokimi i rregullatorit të tensionit nën ngarkesë			Nënkupton një veprim që bllokton pajisjen e rregullatorit të tensionit nën ngarkesë gjatë një ndodhie të tensionit të ulët me qëllim që të ndalojë transformatorët nga ndryshimi i mëtejshëm dhe ulja e mëtejshme e tensioneve në një zonë.
Centrali i gjenerimit			do të thotë centrali që konverton energjinë primare në energji elektrike dhe që përbëhet nga një ose më shumë module gjeneruese të kyçur në rrjet në një ose më shumë pikat të kyçjes

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Certifikues i autorizuar			nënkupton një entitet që lëshon certifikata të pajisjeve dhe dokumentet e modulit gjenerues dhe akreditimi i të cilit është dhënë nga agjensioni kombëtar për bashkëpunim me akreditimin Evropian (EA), apo një autoritet tjetër kombëtar.
Certifikata të pajisjeve			Do të thotë dokument i lëshuar nga një certifikues i autorizuar për pajisjet e përdorura nga moduli gjenerues, njësia e kërkesës, sistemi i shpërndarjes, stabilimenti i kërkesës. Certifikata e pajisjes përcakton fushën e vlefshmërisë së saj në nivelin kombëtar ose në nivelin tjetër ku përzgjidhet vlera specifike nga brezi i lejuar në nivel evropian. Me qëllim të zëvendësimit të pjesëve specifike të procesit të pajtueshmërisë, certifikata e pajisjes mund të përfshijë modele që janë verifikuar kundrejt rezultateve aktuale të testimit.
De-energizim			Do të thotë izolim nga të gjitha kyçjet me ndonjë sistem elektrik përfshirë sistemin e transmetimit , sistemet dhe pajisjet e shfrytëzuesve të tjerë.
Deklarata e pajtueshmërisë			Do të thotë dokument i siguar nga pronari i centralit gjenerues, pronari i stabilimentit të kërkesës, operatori i sistemit të shpërndarjes tek operatori i sistemit të transmetimit duke deklaruar statusin aktual të pajtueshmërisë me specifikimet dhe kërkesat përkatëse.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Derogim			Një përjashtim i lejuar – normalisht për një periudhë të caktuar kohore – që i lejohej një pale të vazhdojë operimin normal edhe pse nuk është në gjendje të plotësojë të gjitha kërkesat e Kodit të Rrjetit .
Devijim i frekuencës			Një shmangie e frekuencës aktuale të sistemit nga vlera e frekuencës së synuar.
Devijim i paqëllimshëm			Diferenca ndërmjet shkëmbimit aktual të energjisë që ka ndodhur në një interval të caktuar kohe (shkëmbimi fizik i paqëllimshëm i energjisë së një zone rregulluese) dhe programit të planifikuar të një zone rregulluese (ose blloku rregullues), pa marrë parasysh efektin e ndikimit të frekuencës.
Diagrami i aftësisë P-Q			nënkupton diagramin që përshkruan aftësinë për fuqi reaktive të një moduli gjenerues në kontekstin e ndryshimit të fuqisë aktive në pikën e kyçjes
Dispeçimi			Menaxhim i rrjedhave të energjisë elektrike në rrjet në mënyrë që furnizimi dhe kërkesa për energji elektrike të jenë në balancë.
Dita e dispeçimit fizik			I referohet ditës në të cilën centrali elektrik dispeçohet për të balancuar sistemin në kohë reale.



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Dokumenti i instalimit			Do të thotë një dokument i thjeshtë i strukturuar që përmban informacion në lidhje me njësinë e kërkesës, të kyçur në nivelin më të ulët se 1 kV dhe konfirmimin e përputhjes me kërkesat përkatëse.
Dokumentacioni i njësisë së reagimit të kërkesës (DNRK)			Nënkupton një dokument, të lëshuar nga pronari i stabilimentit të kërkesës tek operatori përkatës i sistemit për njësitë e kërkesës me reagim të kërkesës dhe të kyçur në nivelin e tensionit mbi 1 000 V, që konfirmon pajtueshmërinë e stabilimentit të kërkesës me kërkesat teknike të përcaktuara në këtë kod dhe siguron të dhënat dhe deklaratat e nevojshme, duke përfshirë një deklaratë të pajtueshmërisë.
Dorëzim			Informacioni mbi dërgimin dhe marrjen e planifikuar të energjisë elektrike që i ofrohet Operatorit të Sistemit nga një palë tregtare .
Energjia aktive		Wh kWh MWh	Energjia elektrike aktive është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe, duke qenë integrali i caktuar i fuqisë aktive me kufij kohe.
Energjia reaktive		VArh KVARh	Është integrali i caktuar me kufij kohe i fuqisë reaktive matur në njësi me volt-amper-reaktiv-orë.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
ENTSO-E			Është Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energji Elektrike.
Faktori i fuqisë			Do të thotë raporti i vlerës absolute të fuqisë aktive ndaj fuqisë së dukshme
Forca madhore			Është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.
Formulari i sigurisë brenda sistemit			Një formular i shkruar i masave paraprake të sigurisë brenda sistemit i përpiluar në përputhje me rregullat e koordinimit të sigurisë



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Frekuenca			Nënkupton frekuencën elektrike të sistemit e shprehur në Hz e cila mund të matet në të gjitha pjesët e zonës sinkrone me supozimin e vlerës konsistente për sistemin në brezin kohor të disa sekondave, me vetëm disa diferenca të vogla në mes të lokacioneve të ndryshme të matjes. Vlera nominale e saj është 50 Hz.
Fuqia aktive		W, kW, MW	Nënkupton komponentën reale të fuqisë së dukshme për frekuencën bazë e shprehur në W ose shumëfishat kW, MW
Fuqia reaktive		VAr KVAR	Nënkupton komponentën imagjinare të fuqisë së dukshme për frekuencën bazë e shprehur në VAr ose shumëfishat kVAR.
Furnizues			Ndërmarrja e energjisë elektrike e licencuar për të kryer veprimtarinë e furnizimit.
Gabimi i Zonës Rregulluese	GZRr (ACE)		Diferenca momentale ndërmjet vlerës aktuale dhe asaj referente (vlera totale e matur e energjisë dhe programi i përcaktuar rregullues) për shkëmbimin e energjisë së një zone rregulluese (devijimi i paqëllimshëm) , duke marrë parasysh ndikimin e një shmangie të frekuencës për atë zonë rregulluese sipas karakteristikave frekuencë - fuqi të rrjetit të asaj zone rregulluese dhe devijimit të përgjithshëm të frekuencës.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Hydrocentral reverzibil			Do të thotë njësi hidro në të cilën uji mund të ngritet me anë të pompave dhe të akumulohet.
Humbjet në rrjetë (sistem)			Humbjet e përgjithshme të energjisë elektrike në rrjetin përkatës të energjisë elektrike. Humbjet në rrjetë zakonisht konsiderohen ndaras për rrjetin e transmetimit dhe për rrjetin e shpërndarjes.
Incident i rëndësishëm			Një ndodhi/ngjarje të cilën OST ose një përdorues konsideron se ka pasur ose mund të ketë një ndikim të rëndësishëm mbi Sistemin e Transmetimit .
Incident i përbashkët i sistemit			Një ndodhi në sistemin e një pale që ka pasur ose mund të ketë pasur një ndikim serioz ose të gjerë në sistemin e një pale tjetër.
Inercion			Nënkupton vetinë e trupit të ngurtë rrotullues siç është rotor i një alternatori i cili mirëmbanë apo ruan gjendjen uniforme të lëvizjes rrotulluese dhe momentin këndor përderisa një moment i jashtëm nuk aplikohet
Inercion artificial			Do të thotë stabilimenti i ofruar nga moduli i parkut gjenerues për të zëvendësuar efektin e inercionit të modulit gjenerues sinkron në nivel të përcaktuar të performancës.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Instalimet matëse			Pajisjet e nevojshme për matje që ndodhen ndërmjet pikës së matjes dhe pikës së kyçjes me rrjetin.
Instruksione			Nënkupton çdo komandë, brenda autoritetit të saj, të dhënë nga operatori i sistemit tek pronari i centralit të gjenerimit, pronari i stabilimentit të kërkesës, operatori i sistemit të shpërndarjes për të kryer një veprim
Interkonektor			Linja e transmetimit që kalon apo përshkon kufirin ndërmjet Kosovës dhe të Palëve Kontraktuese dhe lidh sistemet kombëtare të transmetimit të Palëve Kontraktuese.
Interkonekcioni			Një kyçje ndërmjet dy ose më tepër OST-ve, zonave rregulluese ose blloqeve rregulluese.
Kapaciteti Paraprakisht i Alokuar	KPA (AAC)		Sasia totale e të drejtave të ndara për transmetim, qoftë ato për kapacitete apo programe shkëmbimi varësisht nga metoda e alokimit.
Kapaciteti maksimal	Pmax		Nënkupton fuqinë aktive maksimale të vazhdueshme që moduli gjenerues mund të prodhojë, duke zbritur shpenzimet vetanake që nuk injektohen në rrjet siç është specifikuar në marrëveshjen e kyçjes ose siç është rënë dakord midis operatorit përkatës të sistemit dhe pronarit të centralit të gjenerimit

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Kapaciteti Total i Transmetimit	KTT (TTC)		Programi maksimal i shkëmbimit ndërmjet dy zonave rregulluese fqinje që përputhet me standardet e sigurisë së operimit të aplikuara në secilin sistem (p.sh. Kodi i Rrjetit) nëse kushtet e rrjetit në të ardhmen, gjenerimit dhe skemës së ngarkesës janë saktë paraprakisht të njohura.
Kapaciteti Transmetues në Disponim	KTD (ATC)		Është kapaciteti transmetues interkonektiv (në MW) në një kufi që caktohet nga ana e OST dhe që është i disponueshëm për alokim nga ana e OT . Kapaciteti Transmetues në Disponim (ATC) është pjesë e NTC që mbetet në dispozicion pas secilës fazë të procedurës së ndarjes për aktivitete të mëtejshme komerciale. ATC përcaktohet sipas ekuacionit: $ATC = NTC - AAC$
Kërkesa			Kërkesa është shkalla me të cilën energjia elektrike është dërguar në apo prej një sistemi apo një pjese të sistemit, e shprehur në MW dhe MVA _r (d.m.th. fuqi aktive dhe fuqi reaktive) nëse nuk shprehet ndryshe.
Kërkesa totale			Kërkesa totale në MW e energjisë elektrike për tërë sistemin energjetik të Kosovës.
Kodi i balancit			Kapitulli i Kodit të Rrjetit që mbulon aktivitetet normale në kohë reale të operatorit të sistemit .

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Kodi i dispeçimit			Një seksion i kodit të balancit që mbulon përgjegjësitë e operatorit të sistemit dhe palëve të tjera në balancimin e sistemit në kohë reale.
Kodi i kyçjes			Kapitulli i Kodit të Rrjetit që përfshin kyçjet në Sistemin e Transmetimit .
Kodi i planifikimit			Kapitulli i Kodit të Rrjetit që merret me planifikimin e Sistemit të Transmetimit .
Kodi i planifikimit operativ			Kapitulli i Kodit të Rrjetit që merret me çështjet e planifikimit operativ në periudhën afat shkurtër.
Kodi i planifikimit të ndërprerjeve			Seksion i kodit të planifikimit operativ që merret me njoftimin dhe miratimin e ndërprerjeve në sistemin e transmetimit .
Kodi i planifikimit të rasteve të paparashikuara			Seksion i kodit operativ që mbulon të drejtat dhe detyrimet e palëve të ndryshme në lidhje me masat që duhen ndërmarrë për të parandaluar dhe vënë nën kontroll probleme madhore të sistemit.
Kodi i rregullimit të frekuencës			Seksioni i kodit të balancit që mbulon të drejtat dhe detyrimet e palëve të ndryshme në lidhje me rregullimin e frekuencës në sistemin energjetik të Kosovës
Kodi i rregullimit të ngarkesës			Seksioni i kodit operativ që mbulon të drejtat dhe detyrimet e palëve të ndryshme në lidhje me masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e ngarkesës së sistemit.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Kodi i rregullimit të tensionit			Seksioni i kodit të balancit që mbulon të drejtat dhe detyrimet e palëve të ndryshme në lidhje me rregullimin e tensionit në sistemin energjetik të Kosovës.
Kodi i Standardeve Elektrike			Një dokument që specifikon mes të tjerave standardet e frekuencës dhe tensionit me të cilat operohet sistemi energjetik i Kosovës.
Kodi Operativ			Kapitulli i Kodit të Rrjetit që merret me çështjet operative, si ato që kryhen në baza të rregullta edhe ato që vijnë si rezultat i ngjarjeve të jashtëzakonshme.
Komisioni i incidentit të përbashkët të sistemit			Një komision i ngritur nga OST në mënyrë që të mbikëqyrë një incident të përbashkët të sistemit dhe të merret me të gjitha pyetjet në lidhje me të.
Komisioni Qeverisës i Kodeve Teknike/Operacionale	KQKO		Komisioni i themeluar në përputhje me dispozitat e procedurës së menaxhimit të kodeve teknike/operacionale që mbikëqyrë funksionimin e kodeve teknike dhe operacionale.
Konsumator i mbrojtur			Kategoria e konsumatorëve të cilët lirohen nga zbatimi i masave kufizuese siç pëcaktohet në UA mbi Rregullat për masat kufizuese të furnizimit me energji në situata emergjente
Konsumatori i ngarkesës			Një person apo organizatë të cilit/ës i sigurohet vetëm energji elektrike.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Koordinator i zbatimit të sigurisë			Një koordinator i sigurisë që zbaton masat paraprake të sigurisë për zbatimin e koordinimit të sigurisë ndërmjet sistemeve.
Koordinator i kërkesës të sigurisë			Një person që kërkon masat paraprake të sigurisë për implementimin e koordinimit të sigurisë në sistem.
Koordinator i sigurisë			Një person i cili është emëruar me shkrim nga një palë, OSTT dhe shfrytëzuesi , i cili do të jetë i autorizuar të ndërmerre izolim dhe tokëzimin në vendet e kyçjes.
Kompensator statik	SVC		Një pajisje elektrike e dizajnuar për të gjeneruar dhe për të absorbuar energji reaktive .
Kriteri 'n-1'			Një rregull sipas së cilës elementet e mbetur në funksion pas prishjes të një elementi të sistemit (si p.sh. një linjë transmetimi/transformator apo njësi gjeneruese, ose në disa raste një zbarë) duhet të jenë në gjendje të përshtaten me ndryshimet e rrjedhave në sistem të shkaktuara nga prishja e tillë.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Kufiri i besueshmërisë së transmetimit	KBT (TRM)		<p>Kufiri i sigurisë që merret me pasiguritë në vlerat e përlogaritura të KTT (TTC) që rrjedhin nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Devijimet e paqëllimshme të rrjedhave fizike gjatë operimit për shkak të funksionimit fizik të regullimit sekondar. • Shkëmbimet emergjente ndërmjet OST-ve për të përballuar situatat e paparashikuara të jo-balanceve në kohë reale. • Pasaktësive në grumbullimin dhe matjen e të dhënave.
Kufizimi në transmetim			Situata kur tejkalohe kufijtë termik të tensionit apo stabilitetit të sistemit të transmetimit .
Kyçja			Interkoneksioni i dy sistemeve brenda Kosovës.
Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmetimit			Një licencë e lëshuar nga Rregullatori për OST që përcakton të drejtat dhe detyrimet e të licencuarit në lidhje me Sistemin e Transmetimit që OST ka në pronësi, operon dhe e mirëmban.
Licenca e Operatorit të Tregut			Një licencë e lëshuar nga Rregullatori për OT që përcakton të drejtat dhe detyrimet e të licencuarit në lidhje me operimin e tregut të energjisë elektrike.
Linjë elektrike (elektronike)si bartëse e informatave	PLC		Sistemi për bartjen e informatave duke përdorur linjat energjetike ekzistuese.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Limituesi i mbi-eksitimit			Nënkupton pajisjen e rregullimit brenda RAT i cili parandalon mbingarkimin e rotorit të një alternatori duke kufizuar rrymën e eksitimit.
Limituesi i nën-eksitimit			Nënkupton pajisjen e rregullimit brenda RAT i cili parandalon humbjen e sinkronizimit të alternatorit në mungesë të eksitimit.
Margjina e operimit			Prodhimi shtesë i gjenerimit – mbi atë të kërkuar për të përmbushur kërkesën – që kërkohet për të ofruar rezervën dhe përgjigjen ndaj frekuencës në kohë reale në mënyrë që të garantohet siguria e sistemit.
Marrëveshja e Kycjes	MK		Nënkupton kontratën ndërmjet operatorit përkatës të sistemit dhe pronarit të centralit të gjenerimit, pronarit të kërkesës, operatorit të sistemit të shpërndarjes, i cili përfshin vendndodhjen përkatëse dhe kërkesat specifike teknike për centralin e gjenerimit, stabilimentin e kërkesës, sistemin e shpërndarjes.
Marrëveshja e Shërbimeve Ndhëmëse	MShN (ASA)		Një marrëveshje dypalëshe ndërmjet OSTT dhe një pale tregtare për të siguruar një shërbim ndihmës .
Marrëveshja Kornizë e Rregullave të Tregut			Një marrëveshje në formën e përcaktuar në rregullat e tregut nëpërmjet të cilës palët nënshkruese dakordohen t'iu binden rregullave të tregut .



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Masat paraprake të sigurisë			Kryerja e vetëm një apo më shumë veprimeve si – ndarja (izolimi), tokëzimi , etj.
Mbrojtja			Pajisjet mbrojtëse që normalisht mbulojnë një element të vetëm në stabiliment që zbulon një situatë potencialisht të rrezikshme apo jonormale në sistem dhe dërgon sinjalin për ndërprerësin e qarkut në mënyrë që të ndërpresë elementin e stabilimentit prej sistemit.
Mekanizmi balancues	MB		Është proces në të cilin Palët Tregtare i dorëzojnë Ofertat për Blerje dhe Ofertat për Shitje të energjisë OST , me qëllim të realizimit të Balancimit të Sistemit të Transmetimit në kohë reale.
Menaxhimi i sigurisë			Procesi për të siguruar që sistemi i tensionit të lartë për personelin është në gjendje të sigurtë për ndërmarrjen e punimeve dhe/ose testeve
Menaxhimi i kufizimeve në rrjetin e transmetimit përmes reagimit të kërkesës			Do të thotë kërkesa brenda një stabilimenti të kërkesës që është në dispozicion për modulimin nga operatori përkatës i sistemit apo OST për të menaxhuar kufizimet e transmetimit brenda sistemit
Modul gjenerues			Do të thotë një modul gjenerues sinkron ose moduli i parkut gjenerues.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Moduli i parkut gjenerues			Nënkupton njësinë ose grumbull të njësive që gjenerojnë energji elektrike, të cilat ose janë të kyçura në mënyrë sinkrone me rrjetin ose të kyçur përmes konvertorëve (elektronikës) të fuqisë dhe gjithashtu kanë një pikë të vetme të kyçjes me sistemin e transmetimit, sistemin e shpërndarjes.
Moduli gjenerues sinkron ⁷			Nënkupton një grup të pandashëm instalimesh që mund të gjenerojnë energji elektrike në mënyrë të tillë që frekuenca e tensionit të gjeneruar, shpejtësia e generatorit dhe frekuenca e tensionit të rrjetit të jenë në raport konstant dhe në sinkronizëm.
Modusi senzitiv në frekuencë	MSF		Nënkupton mënyrën e operimit të modulit gjenerues në të cilin ndryshimi i fuqisë aktive me reagim ndaj ndryshimit në frekuencën e sistemit, në mënyrë të tillë që të asistojë me rivendosjen e frekuencës së synuar.
Modusi senzitiv në frekuencë i kufizuar - mbifrekuenca	MSFK-M		Nënkupton modulën gjenerues , i cili do të rezultojë në reduktimin e fuqisë aktive me reagim ndaj ndryshimit në frekuencën e sistemit mbi vlerën e synuar.
Modusi senzitiv në frekuencë i kufizuar - nënfrekuenca	MSFK-N		Nënkupton modulën gjenerues i cili do të rezultojë me rritjen e gjenerimit të fuqisë aktive me reagim ndaj ndryshimit në frekuencën e sistemit nën vlerën e synuar;



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Mundësia funksionale e shkyçjes së kërkesës nga nën-tensioni			Nënkupton një veprim të restaurimit ku kërkesa është shkyçur gjatë një ndodhie të paraqitjes së tensionit të ulët në mënyrë që të rimëkëmbë tensionin në kufij të pranueshëm.
Ndarja (Izolimi)			Procesi i arritjes së ndarjes elektrike të një përcuesi nga pjesa tjetër e sistemit.
Ndërprerje			Akti fizik i ndarjes së sistemeve/objekteve të shfrytëzuesve të sistemit nga Sistemi i Transmetimit.
Ndodhi/Ngjarje			Një dukuri e paplanifikuar në SEE që përfshin prishjet, incidentet dhe rëniet e SEE.
Neto Kapaciteti i Transmetimit	NKT (NTC)		Neto Kapaciteti i Transmetimit përkufizohet si: $NTC = TTC - TRM$ NTC është programi i shkëmbimit maksimal të përgjithshëm ndërmjet dy OST-ve (Zonave rregulluese) të afërta në pajtueshmëri me standardet e aplikueshme të sigurisë në interkoneksion dhe duke pasur parasysh të gjitha pasiguritë në konditat e ardhshme të sistemit.
Ngarkesa			Fuqia aktive, fuqia reaktive , ose fuqia e dukshme, sipas kontekstit, që gjenerohet, transmetohet apo shpërndahet.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Niveli minimal i rregullimit			Nënkupton fuqinë aktive minimale, siç përcaktohet në marrëveshjen e kyçjes ose siç është rënë dakord midis operatorit përkatës të sistemit dhe pronarit të centralit të gjenerimit, deri në të cilën moduli gjenerues mund të rregullojë fuqinë aktive
Niveli minimal i operimit stabil			Nënkupton fuqinë aktive minimale siç është specifikuar në MK ose siç është dakorduar në mes të OST dhe pronarit të centralit gjenerues për të cilën moduli gjenerues mund të operoj në mënyrë stabile për kohë të pakufizuar.
Njësi transformatorike e gjenerimit			Një transformator i lidhur direkt në dalje të njësisë gjeneruese që furnizon pjesët ndihmëse të njësisë gjeneruese .
Njësia balancuese			Një njësi gjeneruese apo ndonjë pjesëmarrës tjetër fizik i aftë për të postuar oferta për shitje - blerje në mekanizmin balancues .
Njësia e dispeçimit			Një njësi gjeneruese ose konsumator i ngarkesës që është objekt i udhëzimeve të dispeçimit nga OST .
Njësi (Modul) gjeneruese			Grup pajisjesh që prodhojnë energji elektrike.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Njësia gjeneruese e startimit nga errësira (zero)			Njësia gjeneruese që është në gjendje të kyçet apo të jetë në funksionim pa burimin normal të jashtëm të energjisë dhe kështu ka aftësinë për të riaktivizuar sistemin energjetik pas një rënie .
Njësi e kërkesës			Nënkupton grupin e instalimeve që përmbajnë pajisje që mund të kontrollohen në mënyrë aktive nga pronari i stabilimenteve të kërkesës, individualisht ose zakonisht si pjesë e ngarkesës së grumbulluar nëpërmjet një pale të tretë.
Njoftimi fizik	NjF (PN)		Njoftimi i dhënë nga pala tregtare për operatorin e sistemit që specifikon dërgimin e synuar në MW ose marrjen gjatë një dite të specifikuar.
Njoftimi për operim final	NOF		Nënkupton njoftimin e lëshuar nga operatori i sistemit të transmetimit tek pronari i centralit gjenerues, pronari i stabilimentit të kërkesës, operatori i sistemit të shpërndarjes, i cili është në përputhje me specifikimet dhe kërkesat përkatëse, duke lejuar atyre që të shfrytëzojnë kyçjen në rrjet.
Njoftimi për operim gjatë energjizimit	NOE		Nënkupton njoftimin e lëshuar nga operatori i sistemit të transmetimit tek pronari i centralit gjenerues, pronari i stabilimentit të kërkesës, operatori i sistemit të shpërndarjes, para energjizimit të rrjetit të tij të brendshëm.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Njoftimi për operim të përkohshëm	NOP		nënkupton njoftimin e lëshuar nga operatori i sistemit të transmetimit tek pronari i centralit gjenerues, pronari i stabilimentit të kërkesës, operatori i sistemit të shpërndarjes i cili u lejon atyre të operojnë duke përdorur kyçjen në rrjet për një periudhë të kufizuar kohore dhe për të iniciuar testet e pajtueshmërisë për të siguruar pajtueshmërinë me specifikimet dhe kërkesat përkatëse;
Njoftimi për operim të kufizuar	NOK		Nënkupton njoftimin e lëshuar nga operatori i sistemit të transmetimit tek pronari i centralit gjenerues, pronari i stabilimentit të kërkesës, operatori i sistemit të shpërndarjes i cili ka arritur më parë statusin NOF, por përkohësisht është subjekt i modifikimit të rëndësishëm ose humbjes së aftësisë që rezulton në mos - përputhje me specifikimet dhe kërkesat përkatëse
Ngarkesa në blloqe			Nënkupton ngarkimin maksimal shkallë me fuqi aktive të kërkesës së rikyçur gjatë restaurimit të sistemit pas rënjes totale të sistemit.
Ngarkesat e grumbulluara			Nënkupton një grup të stabilimenteve të kërkesës të cilat mund të funksionojnë si një strukturë e vetme me qëllim të sigurimit të një ose më shumë shërbimeve të reagimit të kërkesës.



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Oferta për shitje (offer)			Është ofertë për t'i shitur energji elektrike OST nëpërmjet mekanizmit balancues me çmim të dhënë në (€/MWh) nga Pala Tregtare për një Njësi Balancuese.
Ofertë për blerje (bid)			Është ofertë për të blerë energji elektrike nga OST në Mekanizmin Balancues me çmim të dhënë në (€/MWh) nga Pala Tregtare për një Njësi Balancuese të caktuar.
Ofruesi i Shërbimeve Ndhmëse	OShN (ASP)		Një që ofron shërbime ndihmëse për OSTT .
Operator Sistemi Transmetimi dhe Tregu	OSTT		Është Operator i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, i cili është përgjegjës për planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë, sigurimin e qasjes së hapur dhe jodiskriminuese dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike.
Operatori i Sistemit	OS		Departamenti brenda OSTT që është përgjegjës për operimin e sistemit të transmetimit përfshirë dispečimin ekonomik, sigurinë dhe cilësinë e furnizimit në Sistemin e Transmetimit .



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Operatori i Sistemit të Transmetimit	OST		Person fizik ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar përfshirë kurdo që kjo është e mundur interkonektorët me sistemet tjera dhe për të garantuar aftësinë afatgjatë të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike.
Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	OSSH		Ka kuptimin si në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085.
Operatori i sistemit të shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit			Nënkupton sistemin e shpërndarjes të kyçur në sistemin e transmetimit, duke përfshirë stabilimentet e shpërndarjes të kyçura në rrjetin e transmetimit.
Operatori i Tregut			Personi fizik ose juridik, i licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe është përgjegjës për të operuar dhe organizuar tregun e energjisë elektrike në Kosovë.
Operimi ne ishull			Nënkupton operimin e pavarur të rrjetit të tërë ose të një pjese të rrjetit që është izoluar pas shkyçjes nga sistemi i ndërlidhur, që ka të paktën një modul gjenerues që furnizon me energji rrjetin dhe kontrollon frekuencën dhe tensionin



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Operimi në ngarkesën vetanake			Do të thotë operimin që siguron se centrali gjenerues është në gjendje të vazhdoj të furnizoj ngarkesën e tij vetanake në rast të dështimeve në rrjet, duke rezultuar që modulet gjeneruese të shkyçen nga rrjeti dhe të futen në furnizimet e tyre ndihmëse.
Orari i shkëmbimit			Një shkëmbim i dakorduar në lidhje me sasinë (MW), kohën e fillimit dhe të përfundimit, periudhën e shkallshmërisë (modulimit) dhe tipin (p.sh. qëndrueshmëria); që është i nevojshëm për dhënien dhe marrjen e fuqisë dhe energjisë ndërmjet palëve kontraktuese dhe OST-ve, ndërmjet OST-ve dhe zonave rregulluese, ose ndërmjet zonave rregulluese dhe blloqeve rregulluese të përfshira në shkëmbim.
Orari i miratuar			Një orar që i është paraqitur dhe është miratuar nga OST dhe aplikohet për orarin e ditës korresponduese dhe është i detyrueshëm për palën që e paraqet.
Pajisje tokëzimi			Një pajisje e fiksuar apo portative për sigurimin e kyçjes mes një përçuesi dhe tokës.
Pajisjet kryesore të kërkesës			Nënkupton të paktën një nga pajisjet si: motorët, transformatorët, pajisjet e tensionit të lartë në pikën e kyçjes dhe në procesin e prodhimit të centralit.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Palë			Çdokush që operon në tregun e organizuar të energjisë elektrike të Kosovës ose kryen shërbime për të bërë të mundur funksionimin e tregut.
Palë Tregtare			Është një Prodhues, Furnizues, Tregëtarë ndërkufitar, Furnizues me shumicë ose palë tjetër që ka aderuar në Rregullat me qëllim të tregtimit të energjisë elektrike.
Pandjeshmëria e reagimit në Frekuencë			Do të thotë veti inherente e sistemit rregullues e specifikuar si amplitudë minimale e ndryshimit në frekuencë apo sinjalit hyrës që rezulton me ndryshimin e fuqisë dalëse apo sinjalit dalës.
Parashikimi i kërkesës nga OST			Një vlerësim i kërkesave për fuqi aktive dhe fuqi reaktive i përgatitur nga OST në intervale të rregullta.
Parashikimi i kërkesës së tregut			Një vlerësim i kërkesave për energji aktive bazuar në kontratat dypalëshe të dakorduara mes pjesëmarrësve në treg .
Pengesa në sistem			Pengesa brenda sistemit të transmisionit që kufizon sasinë e energjisë që mund të transmetohet mes pjesëve të sistemit për shkak të shkeljes së kufijve të stabilitetit termik apo të tensionit.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Pikë e Kyçjes			Nënkupton pikën e ndërlidhjes në të cilën moduli gjenerues, stabilimenti i kërkesës, sistemi i shpërndarjes është i lidhur me sistemin e transmetimit, sistemin e shpërndarjes, siç është identifikuar në marrëveshjen e kyçjes
Pika e punës			Do të thotë vlera e synuar për çdo parametër që zakonisht përdoret në skemat e rregullimit.
Pjerrtësia			Nënkupton raportin e ndryshimit të tensionit bazuar në vlerën referente 1 p.u, ndaj ndryshimit të fuqisë të injektuar reaktive nga zero deri te fuqia maksimale reaktive, bazuar në vlerën maksimale të fuqisë reaktive.
Pjesëmarrësi i mekanizmit balancues			Një palë që merr pjesë në mekanizmin balancues .
Pjesëmarrësi në treg			Një person fizik apo juridik që operon ose furnizohet nga sistemi energjetik i Kosovës.
Plani mbrojtës			Plani i përgatitur dhe i azhurnuar nga OST që detajon masat e përdorura për të siguruar me sa është e mundur funksionimin paralel të qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit energjetik të Kosovës.
Plani i startimit nga errësira			Plani i përgatitur dhe azhurnuar rregullisht nga OST për restaurimin e sistemit energjetik në rast të një rënie totale ose rënie të pjesshme .



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Plani i krizës së Qendrës së kontrollit (Qendrës Dispeçerike)			Një plan i përgatitur dhe mirëmbajtur nga OST që detajon hapat që duhen ndërmarrë në rast se qendra e kontrollit bëhet e papërdorshme.
Plani Zhvillimor i Transmetimit	PZhT		Plani që hartohet çdo vit dhe që propozon zhvillimet e ardhshme të sistemit energjetik për 10 vitet në vazhdim duke pasur parasysh parashikimet e kërkesës, zhvillimin e rrjetit, gjenerimit dhe dekomisionimin.
Power System Simulation for Engineering	PSS/E		Është pajisje softuerike për simulimin e rrjeteve të transmetimit
Prishjet e izoluar			Nënkupton një prishje që eliminohet me sukses sipas kriterëve të planifikimit të operatorit të sistemit.
Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale			Procedura e qeverisjes së kodeve teknike/operacionale e nxjerr nga Rregullatori
Programi i shkëmbimit			Totali i planifikuar i shkëmbimit të energjisë ndërmjet dy OST-ve, zonave rregulluese apo blloqeve të rregulluese.
Prodhimi (Gjenerimi)			Prodhimi i energjisë elektrike

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Prodhuesi (Gjeneruesi)			Person fizik apo juridik që prodhon energji elektrike duke përfshirë zhvilluesit (në cilësinë e tyre si aplikues për kyçe) dhe operatorët të të gjitha Parqeve të Energjisë me Erë (Wind farms) të kyçura në rrjetin e transmetimit dhe ato me kapacitet të instaluar $\geq 10 \text{ MW}$ që janë të kyçura (ose kanë aplikuar të kyçen) në rrjetin e shpërndarjes.
Profili U-Q/ P_{\max}			Nënkupton profilin që përfaqëson aftësinë për fuqi reaktive të modulit gjenerues në kontekst të ndryshimit të tensionit në pikën e kyçjes.
Pronar i centralit të gjenerimit'			Do të thotë personi fizik ose juridik që zotëron një central të gjenerimit
Qendra dispeçerike			Nënkupton qendrën e operimit të një operatori të sistemit përkatës.
Reduktimi i ngarkesës nga nën-frekuenca			Shkyçja automatike e ngarkesës nëpërmjet një releu matës elektrik i cili vepron me arritjen e vlerës së karakteristikës nga nënfrekuenca.
Reduktimi i ngarkesës me rotacion			Procesi dhe aranzhimet për shkyçjen e ngarkesës në mënyrë të përsëritur duke ndjekur një cikël të planifikuar dhe të njoftuar paraprakisht në mënyrë që të balancojë furnizimin me ngarkesën .
Rënie e pjesshme			Dështimi në furnizimin me energji elektrike në një pjesë të madhe të sistemit energjetik të ndërlidhur në Kosovë.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Rënie			Do të thotë raporti i ndryshimit të frekuencës në gjendje të qëndrueshme ndaj ndryshimit të fuqisë aktive në gjendje të qëndrueshme e shprehur në përqindje. Ndryshimi në frekuencë shprehet si raport me frekuencën nominale dhe ndryshimi në fuqinë aktive e shprehur si raport me kapacitetin maksimal ose fuqinë aktuale aktive në momentin kur arrihet pragu relevant.
Rezerva e rregullimit primar			Është pjesa (pozitive/negative) e brezit të rregullimit primar e matur nga pika e punës para çrregullimit deri në fuqinë maksimale të rregullimit primar (duke marrë parasysh limituesit). Koncepti i Rezervës së Rregullimit Primar vlen për çdo gjenerues, çdo zonë/bllok rregullues dhe tërë zonën sinkronizuese.
Rezerva e rregullimit sekondar			Rezerva e rregullimit sekondar (pozitive/negative) është pjesa e brezit të rregullimit sekondar ndërmjet pikës së punës dhe vlerës maksimale/minimale. Pjesa e brezit të rregullimit sekondar tashmë të aktivizuar në pikën e punës është fuqia e rregullimit sekondar.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Rezerva e rregullimit terciar			Fuqia që mund të kyçet (automatikisht apo) manualisht nën rregullimin terciar, në mënyrë që të siguroj rezervën adekuate të rregullimit sekondar, njihet si rezerva e rregullimit terciar ose rezerva minutëshe. Rezerva duhet të përdoret në at mënyrë të tillë që kontribuoj në rikthimin e brezit të rregullimit sekondar në rastet kur kërkohet.
Rregulla për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë në Kosovë			Rregulla të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, që paraqesin bazën për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë.
Rregullat e sigurisë			Rregullat e detyrueshme të OST ose një shfrytëzuesi që kërkojnë të sigurojnë se personat që punojnë në stabilimentin apo aparaturat për të cilat aplikohen rregullat, janë të sigurtë nga rreziqet në sistem.
Rregullat e Tregut			Normat të cilat rregullojnë tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve në treg dhe marrëdhëniet ndërmjet palëve në tregun e energjisë elektrike, Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, me qëllim të mirëmbajtjes së balancit fizik të tregut.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Rregullatori	ZRrE		Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) , është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë e themeluar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë .
Rregullimi Automatik i Gjenerimit	RAG (AGC)		Është pajisja që automatikisht përshtatë prodhimin për të ruajtur dispeçimin e prodhimit, programin e shkëmbimit plus pjesën e vet të rregullimit të frekuencës. RAG është një kombinim i rregullimit sekondar për zonën/bllokun rregullues dhe dispeçimit të prodhimit (bazuar në programin e prodhimit).
Rregullatori Automatik i Tensionit	RAT (AVR)		Nënkupton pajisjet automatike që veprojnë vazhdimisht duke kontrolluar tensionin e terminalit të modulit sinkron të gjenerimit duke krahasuar vlerën aktuale të tensionit të terminalit me vlerën referente dhe duke kontrolluar rrymën dalëse të sistemit të eksitimit
Rregullatorët e tensionit nën ngarkesë			Nënkupton pajisjen për ndryshimin e pozitës së rregullatorit, të përshtatshme për operim përderisa transformatori është i energjizuar ose nën ngarkesë.
Rregullimi i fuqisë aktive përmes reagimit të kërkesës			Do të thotë kërkesa brenda stabilimentit të kërkesës që është në dispozicion për modulimin nga operatori përkatës i sistemit ose OST , që rezulton në modifikim të fuqisë aktive.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Rregullimi i fuqisë reaktive përmes reagimit të kërkesës			Do të thotë fuqia reaktive ose pajisjet kompensuese të fuqisë reaktive në stabilimentet e kërkesës që janë në dispozicion për modulim nga operatori përkatës i sistemit ose OST .
Rregullimi i frekuencës përmes reagimit të kërkesës			Do të thotë kërkesa brenda një stabilimenti të kërkesës që është në dispozicion për reduktim ose rritje me reagim ndaj luhatjeve të frekuencës, të bëra me reagim autonom nga stabilimenti i kërkesës për të zvogëluar këto luhatje.
Rregullim i shpejtë i fuqisë aktive përmes reagimit të kërkesës			Do të thotë kërkesa brenda një stabilimenti të kërkesës që mund të modulohet shumë shpejt me reagim ndaj devijimit të frekuencës, që rezulton në një modifikim shumë të shpejtë të fuqisë aktive.
Rregullimi i ngarkesës			Procedurat që mund të përdoren në mënyrë të veçantë për të reduktuar ose rritur ngarkesën kur ka një mospërputhje serioze ndërmjet prodhimit dhe ngarkesës në një pjesë të sistemit apo në sistemin total.
Rregullimi i frekuencës			Nënkupton aftësinë e modulit gjenerues për të përshtatur fuqinë aktive të prodhuar me reagim ndaj devijimit të frekuencës së matur të sistemit nga një pikë e punës, në mënyrë që të mbajë frekuencën stabile të sistemit.

Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Rregullimi primar			Funksioni automatik i decentralizuar i rregullatorit të turbinës për të rregulluar prodhimin e një njësie gjeneruese si pasojë e devijimit të frekuencës në zonën sinkronizuese.
Rregullimi sekondar			<p>Një funksion automatik i centralizuar për të rregulluar gjenerimin në një zonë rregulluese bazuar në rezervat e rregullimit sekondar me qëllim për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të mbajtur rrjedhat e shkëmbimit të energjisë në programin kontrollues me të gjitha zonat e tjera rregulluese (dhe të korrigjoj humbjen e kapacitetit në një zonë rregulluese të ndikuar nga një humbje e prodhimit), në të njëjtën kohë - (në rast të një devijimi të madh të frekuencës që e ka prejardhjen nga zona rregulluese, veçanërisht pas humbjes së një njësie të madhe gjeneruese) për të rivendosur frekuencën në rast të një devijimi të frekuencës të krijuar nga zona rregulluese në vlerën e tij të përcaktuar me qëllim të lirit të kapacitetit të angazhuar nga rregullimi primar (dhe për të rivendosur rezervën e rregullimit primar)



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Rregullimi terciar			Çdo ndryshim automatik apo manual në pikat e punës së generatorit (kryesisht duke ri-programuar) me qëllim për të rivendosur një rezervë të mjaftueshme të rregullimit sekondar në kohën e duhur.
Rrjeti			Nënkupton stabilimentin dhe aparaturat të kyçur së bashku për të transmetuar ose shpërndarë energji elektrike
RRyma			Nënkupton shkalla e rrjedhjes së ngarkesës elektrike e cila matet me vlerën efektive të sekuencës positive të fazorit të rrymës në frekuencën bazë.
Rryma e shpejtë e prishjes			Do të thotë rryma e injektuar nga moduli i parkut gjenerues gjatë dhe pas një devijimi të tensionit të shkaktuar nga një prishje elektrike me qëllim të identifikimit të prishjes nga sistemi i mbrojtjes së rrjetit në fazën fillestare të prishjes, duke përkrahur mbajtjen e tensionit të sistemit në fazën e mëvonshme të prishjes dhe rimëkëmbjen e tensionit të sistemit pas eliminimit të prishjes.
SCADA			Shkurtesa për Sistemin e Kontrollit, Mbikëqyrjes dhe Grumbullimit të të Dhënave, sistem kompjuterik në kohë reale që përdoret për të monitoruar dhe kontrolluar sistemin e transmetimit në kohë reale.



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Siguria e operimit të sistemit			Operimi i vazhdueshëm i sistemit të transmetimit dhe sipas nevojës sistemit të shpërndarjes sipas rrethanave të parashikueshme.
Sistem interkonektiv			Një numër i sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes të ndërlidhura mes vete përmes një ose më shumë interkonektorëve.
Sistemi energjetik			E gjithë infrastruktura e sistemit elektroenergjetik, gjeneratorëve dhe shfrytëzuesve të tjerë të lidhur në sistem.
Sistemi i menaxhimit të sigurisë			Një sistem që përfshin proceset për de-energizimin, ndarjen, tokëzimin dhe lëshimin e lejeve të punimeve.
Sistemi i Transmetimit	ST		Sistemi i përbërë nga kombinimi i linjave, nënstacioneve dhe stabilimenteve të tensionit të lartë që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike.
Sistemi i Shpërndarjes	SSh		Kombinimi i linjave të energjisë elektrike dhe pajisjeve të energjisë elektrike me tension të mesëm dhe të ulët që shërbejnë për shpërndarjen e energjisë elektrike
Sistemi për rregullimin e eksitimit			Do të thotë sistemi i kontrollit riveprues që përfshin makinën sinkrone dhe sistemin e tij të eksitimit



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Statori			Nënkupton pjesën e makinës rrotulluese e cila përfshin pjesët magnetike statike dhe pshtjellat përkatëse.
Stabiliteti i qëndrueshëm			Nënkupton aftësinë e rrjetit apo modulit gjenerues sinkron për të rikthyer apo mirëmbajtur operimin stabil e përcjellur nga pengesat e vogla
Stabilizuesi i oscilimeve të fuqisë	SOF		Nënkupton funksionin shtesë të RAT të modulit sinkron të gjenerimit, qëllimi i të cilit është ti amortizojë oscilimet e fuqisë.
Stabilimenti i kërkesës			Nënkupton stabilimentin që konsumon energji elektrike dhe është i lidhur në një ose më shumë pika kyçese me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes. Sistemi i shpërndarjes dhe / ose furnizimi ndihmës i një moduli gjenerues nuk përbën stabilimentin e kërkesës.
Stabilimenti i kërkesës së kyçur në rrjetin e transmetimit			Nënkupton stabilimentin e kërkesës e cila ka një pikë kyçe me sistemin e transmetimit .
Stabilimenti i shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit			Nënkupton kyçjen e sistemit të shpërndarjes ose centralet elektrike dhe pajisjet e përdorura për kyçe me sistemin e transmetimit .



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Startimi nga errësira (zero)			Procesi i kthimit në gjendjen e mëparshme të sistemit energjetik pas një rënie totale apo të pjesshme dhe ku nuk ka në dispozicion ndonjë furnizim të jashtëm me energji elektrike.
Shërbimet ndihmëse	ShN (AS)		Të gjitha shërbimet e nevojshme për operimin e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes
Shfrytëzues i sistemit			Personat fizik dhe juridik të cilët furnizojnë apo furnizohen përmes sistemit të transmetimit ose shpërndarjes.
Shkyçja			Hapja e një ndërprerësi të qarkut si pasojë e drejtpërdrejtë dhe normalisht e menjëhershme e operimit të një releu apo një pajisjeje mbrojtëse.
Shkyçje totale			Situata ekzistuese kur i gjithë gjenerimi është ndërprerë dhe nuk ka energji elektrike për furnizim, për këtë arsye sistemi energjetik i Kosovës ka pësuar një rënie.
Tokëzimi			Procesi i sigurimit të një kyçjeje ndërmjet një përcjellësi (përçuesi) dhe tokës duke përdorur pajisjen e tokëzimit të dakorduar.



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Transmetim			Transportimi i energjisë elektrike përmes sistemeve të tensionit të lartë dhe sistemeve të interkonektuara të tensionit të lartë, me qëllim të dërgimit deri te konsumatorët fundor apo tek OSSH-të , por pa përfshirë furnizimin.
Transit i deklaruar			Një rrethanë kur ndodhë një eksport i deklaruar i energjisë elektrike dhe ku rruga e nominuar për transaksion përfshin një shtet në të cilin nuk do të realizohet as dërgimi dhe as pranimi korrespondues i energjisë elektrike.
Tregu i organizuar i Energjisë Elektrike			Tregu i organizuar në mënyrë institucionale një ditë para livrimit fizik dhe/ose gjatë ditës së livrimit fizik. Pjesëmarrësit në treg paraqesin ofertat dhe kërkesat e tyre për produkte të paracaktuara dhe të standardizuara të energjisë elektrike për çdo interval kohor një ditë para, ose gjatë ditës së livrimit fizik.
Udhëzimet e dispeçimit			Udhëzimet e dhëna nga OST për shfrytëzuesit që mundëson zbatimin e funksionimit të dispeçimit .
Udhëzimi i kyçje-shkyçjes			Operimi i stabilimentit dhe aparaturave sipas udhëzimit të OST ose një shfrytëzuesi .



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Aftësia maksimale për import			Do të thotë fuqia aktive maksimale e vazhdueshme që një njësi e kërkesës e kyçur në rrjetin e transmetimit ose stabilimenti i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit mund të konsumoj nga rrjeti në pikën e kyçjes , siç përcaktohet në marrëveshjen e kyçjes ose siç është rënë dakord mes operatorit përkatës të sistemit dhe pronarit të stabilimentit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit
Aftësia maksimale për eksport			Nënkupton fuqinë aktive maksimale të vazhdueshme që një njësi kërkesë e kyçur në rrjetin e transmetimit ose stabilimenti i shpërndarjes i kyçur në rrjetin e transmetimit , mund të furnizojë rrjetin në pikën e kyçjes , siç përcaktohet në marrëveshjen e kyçjes ose siç është rënë dakord mes operatorit përkatës të sistemit dhe pronarit të stabilimentit të kërkesës të kyçur në rrjetin e transmetimit ose operatori i sistemit të shpërndarjes të kyçur në rrjetin e transmetimit .



Emri	Shkurtesa	Njësia	Përshkrimi
Zona sinkrone			Nënkupton zonën e mbuluar nga OST-të të ndërlidhura në mënyrë sinkrone, siç janë zonat sinkrone të Evropës kontinentale, Britanisë së Madhe, Irlandës dhe Irlandës së Veriut dhe Nordike si dhe sistemeve energjetike të Lituanisë, Letonisë dhe Estonisë, së bashku të referuara si 'Baltike' të cilat janë pjesë e zonës më të gjerë sinkrone
Zona e vdekur e reagimit ne Frekuencë			Do të thotë intervali i përdorur qëllimisht për të bërë që rregullimi i frekuencës të mos reagojë.